REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQËRIA RAJONALE**
**UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE**

**Nr._______Prot.** **Datë _____.____.2023**

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:**"Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike i objekteve me punonjes sherbimi dhe sisteme alarmi të sinjalizimit e vëzhgimi dhe Shoqerim i Vlerave monetare"**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(**CPV**): **98341140-8 sherbime sigurimi**

VLERA E FONDIT LIMIT: **19 419 560 (nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e peseqind e gjashtëdhjetë ) Lekë pa TVSH**

---

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## I.KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:***Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 "Formulari permbledhes i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP*

*"<u>Autoriteti kontraktor duhet të kërkojëparaqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepërjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël"</u>, Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne siproveparaprakenevendtedisavertetimeveteleshuara nga autoritetetpublikeosepaletetreta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimitpublik".*

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

***Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1**Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës objekt prokurimi.** *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).*

***Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 gërma b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

*Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.*

*OE ofertues duhet te kete kapacitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera minimale e xhiros ne tre vitet e fundit financiare te jete ne masen 40% e fondit te marreveshjes kuader.*

**2.2.2**Kopje te vërtetuar te bilanceve, te audituara nga ekspertet kontabël te licencuar, te konfirmuara nga autoritetet përkatëse te Administratës Tatimore, te tre viteve te fundit (2020, 2021, 2022) ku te pakten ne dy bilancet e njepasnjeshme, nuk ka raport negativ ndermjet aktivit dhe pasivit. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetem ne rastet kur jane ne kushtet e percaktuara nga neni 41, germa 'c' e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar)".

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).*

**Loti 1: "Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike i objekteve me punonjes sherbimi dhe sisteme alarmi të sinjalizimit e vëzhgimi"**

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale,Operatori/et Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose,

b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës se fondit limit të kontratës që prokurohet**.**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

***Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*

*Duke pasur parasysh se sherbimi i sigurie per ruajtjen e ndertesave, aseteve, njerezve dhe pronave eshte nje sherbim shume i rendesishem, eshte pare e arsyeshme qe operatori ekonomik duhet te kete eksperience te meparshme per te garantuar sherbimin e kerkuar dhe per te vertetuar aftesite e tij.*

---

**2.3.2.** 1- Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si me poshte:

a) Liçencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Shërbimi privat të sigurisë fizike", lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014, nën-kategoria 1.3.A.

b) Çertifikatë e Titullarit të Subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Shërbimi privat të sigurisë fizike", nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.

c) Certifikatë e Drejtuesit Teknik, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Shërbimi privat të sigurisë fizike", nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.

d) Çertifikatat e punonjësve të shërbimit, të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Shërbimi privat të sigurisë fizike", nën-kategoria 1.3.A, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për të paktën 28 (njëzetë e tetë) punonjës shërbimi,të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Fier.

e) Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit operatori ekonomik të jetë liçencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe radioalarm në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.

Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë",

sipas të cilit operatori ekonomik të jetë liçencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe radioalarm në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nente 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 22 e vijues te Ligjit nr.75/2014"Për shërbimin privat të sigurisë fizike" si dhe Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Numri i punonjësve është percaktuar duke ju referuar objekteve per te cilat kerkohet te kryhet sherbim, numri i vendrojeve, turneve (I, II, III), si dhe koefiçentit te rojeve per cdo turn 1.66 siç përcaktohet në Udhëzimin të Ministrit të Brendshëm nr.130, date 05.03.2018.*

---

**2.3.3.** 1- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor,** si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik të ketë Qëndër Kontrolli. Për të provuar ekzistencën e saj të paraqitet Akti i Miratimit i Qëndrës së Kontrollit, konform nenit nr. 22 të Ligjit nr.75/2014, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Fier.

b) Operatori Ekonomik te paraqes Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policise Qarku Fier, leshuar jo me pare se 30 dite nga data e hapjes se ofertave, ku të jepet informacioni si meposhte:

1. Për numrin e punonjësve të shërbimit gjithsej, jo më pak se **28** (njezete e tete)punonjës, të çertifikuar në bazë të ligjit nr.75/2014.
2. Të ketë Përgjegjës Shërbimi.
3. Të ketë në funksionim Qënder e Kontrolli.
4. Të ketë në ruajtje objekte me verifikim sinjal alarmi, jo më pak se 7 (shtatë) objekte.
5. Të ketë Grup të gatshëm punonjësisht për verifikim të sinjaleve të alarmit ne qytetin e Lushnjes.

Që nuk ka masë administrative për operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas përcaktimeve të kreut V, të Ligjit nr.75/2014, gjatë viteve 2020, 2021, 2022

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe nenit 19, 20, 22, 38, 39 e vijues të Ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët*

*ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar si dhe besueshmërinë për realizimin me sukses të kontratës. Informacioni i kërkuar, si psh numri i punonjësve të shërbimit, nr.i objekteve me sinjal alarmi që duhet të ofrojë këtë shërbim, janë në përputhje me përmasat e kontratës që do të realizohet, e konkretisht me numrin e objekteve/vendrojeve ku do të kryhet shërbimi, dhe nr. e punonjesve të shërbimit që do të kryejnë shërbim*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vete deklarimit (vërtetimin dhe listëpagesat, neni 82, pika 5/b LPP)*

**2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 30 (tridhjete)**punonjës të siguruar në muaj, 28 (njëzetë e tetë)punonjës shërbimi nen-kategoria 1.3.A, drejtuesin teknik dhe administratorin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Ky kriter eshte specifikuar si meposhte :

a) Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **30 (tridhjete)** punonjës të siguruar në muaj, 28 (njëzetë e tetë)punonjës shërbimi nen-kategoria 1.3.A, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin/titullarin e subjektit.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vete deklarimit (vërtetimin dhe listëpagesat, neni 82, pika 5/b LPP)*

**Argumentim:***Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

*Numri i punonjësve është percaktuar duke ju referuar objekteve për të cilat kërkohet të kryhet shërbim, numri i vendrojeve, turneve (I, II, dhe III), si dhe koefiçentit të rojeve për çdo turn 1.66 siç përcaktohet në Udhëzimin të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.*

---

**2.3.5.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

a) Operatori ofertues të disponojë automjete, në emër të shoqërisë, në pronësi apo të marra me qira, për ndërhyrjet në raste emergjente,jo më pak se 3 (tre) automjet për përballimin e situatave emergjente.

i. Pronësia e automjeteve të vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit të tyre, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

ii. Marrja me qera ose huapërdorja e automjeteve të mësipërme, do të pranohet vetëm nëse kontrata/te qiramarrjes ose të huapërdorjes janë të lidhura para noterit, dhe të shoqëruara me lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.

Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vete deklarimit (dokumentacioni i plote ligjore i mjeteve, neni 82, pika 5/b LPP)

b) Operatori Ekonomik duhet të vertetoje se disponon ne pronësi jo më pak se **7** (shtatë) armë zjarri (krahu ose brezi). Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë:

1. Autorizim për blerje armë **zjarri** lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
2. Kontrate shitblerje arme me një shoqëri të licensuar për shitblerje armësh shoqëruar me numrin serial për secilen armë.
3. Faturat tatimore shoqeruar me mandat pagesat e bankes. Qe konfirmon kryerjen e pageses.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartesisht se kategoria e shërbimit përfshin disponimin e kategorisë së Licensës / Licensave 1.3.A për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, kështu që edhe armët e kërkuara në këtë objekt prokurimi do të përdoren për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike me Roje Private të subjekteve të Licensuara me Kategorinë 1.3.A.

**Argumentimi:***Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

*Automjetet janë kërkuar për raste të ndërhyrjes emergjente, verifikimin e sinjaleve të alarmit si dhe patrullim nga Grupi i Gatshëm pranë objekteve që do të ruhen nga OE. Numri i automjeteve eshte kerkuar ne baze te numrit te objekteve qe do te ruhensi dhe distances qe kane keto objekte nga njera tjetra, gjithsej jane 3 (tre) objekte/vendroje, dhe shperndarjes se objekteve/vendrojeve në sipas qyteteve përkatëse. Dhe 3 (tre) automjetet e kërkuara nga AK janë të mjaftueshme për kryerjen e objektit të prokurimit. Po ashtu numri i automjeteve eshte kerkuar ne baze te numrit te vendndodhjes se objekteve/Arkave dhe distances midis tyre dhe Degeve te Bankave te Nivelit te Dytë. Gjithsej jane 2 (dy) mjete te blinduara, 1 (nje) qe do te kryeje sherbimin ndersa i dyti ne gadishmeri ne rast se difektohet mjeti qe kryen sherbimin.*

*Kriteri për pronësinë e armëve (të gjata dhe të shkurtra) bazohet në nenin 7 e vijues të Ligjit nr. 74/2014 "Për armët" si dhe nenet 32, 33, 34, 35 të Ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Numri i armëve 7 (shtatë) është përcaktuar numrit të vendrojeve 7 (shtatë).*

*Kriteri për pronësinë e armëve (të gjata zjarri) bazohet në nenin 7 e vijues të Ligjit nr. 74/2014 "Për armët" si dhe nenet 32, 33, 34, 35 të Ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Numri i armëve 3 (tre) është përcaktuar numrit të vendrojeve 3 (tre).*

**Loti 2 : "Shoqerim i Vlerave monetare"**

1- Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë si me poshte:

a. Liçencë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e " Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014, nën-kategoria 1.3.B.

b. Çertifikatë e Titullarit të Subjektit, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", nën-kategoria 1.3.B, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.

c. Çertifikatë e Drejtuesit Teknik, e vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e " Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", nën-kategoria 1.3.B, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018.

d. Çertifikatat e punonjësve të shërbimit, të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit në fushën e "Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit", nën-kategoria 1.3.B, lëshuar në bazë të Ligjit nr. 75/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018, për të paktën 3 (tre) punonjës shërbimi,të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit operatori ekonomik të jetë liçencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe radioalarm në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.

**Argumentimi:***Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nente 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 22 e vijues te Ligjit nr.75/2014"Për shërbimin privat të sigurisë fizike" si dhe Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"*

*Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Numri i punonjësve është percaktuar duke ju referuar objekteve per te cilat kerkohet te kryhet sherbim, numri i vendrojeve, turneve (I, II, III), si dhe koefiçentit te rojeve per cdo turn 1.66 siç përcaktohet në Udhëzimin të Ministrit të Brendshëm nr.130, date 05.03.2018.*

---

2- Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor,** si më poshtë:

a) Operatori Ekonomik të ketë Qëndër Kontrolli. Për të provuar ekzistencën e saj të paraqitet Akti i Miratimit i Qëndrës së Kontrollit, konform nenit nr. 22 të Ligjit nr.75/2014, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Fier.

b) Operatori Ekonomik te paraqes Vërtetim Performance nga Drejtoria Vendore e Policise Qarku Fier, leshuar jo me pare se 30 (tridhjetë) dite nga data e hapjes se ofertave, ku të jepet informacioni si meposhte:

1. Për numrin e punonjësve të shërbimit gjithsej, jo më pak se **3** (tre)punonjës, të çertifikuar në bazë të ligjit nr.75/2014, per nenkategorine I.3.B.
2. Të ketë në funksionim Qënder Kontrolli.
3. Të ketë punonjessherbimi (nenkategoria I.3.B) te pajisur me autorizim per mbajtje arme jo me pak se 3 punonjes.
4. Që nuk ka masë administrative për operatorin ekonomik (Subjektin), Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik, sipas përcaktimeve të kreut V, të Ligjit nr.75/2014, gjatë viteve 2020, 2021, 2022.

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe nenit 19, 20, 22, 38, 39 e vijues të Ligjit nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetet teknike, stafin, personelin e nevojshëm të*

*kualifikuar si dhe besueshmërinë për realizimin me sukses të kontratës. Informacioni i kërkuar, si psh numri i punonjësve të shërbimit, nr.i objekteve me sinjal alarmi që duhet të ofrojë këtë shërbim, janë në përputhje me përmasat e kontratës që do të realizohet, e konkretisht me numrin e objekteve/vendrojeve ku do të kryhet shërbimi, dhe nr. e punonjesve të shërbimit që do të kryejnë shërbim*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 9 te DST-ve.Ne rast se operatori shpallet fitues, perpara lidhjes se kontrates duhet te dorezoj dokumentat provuese per vetedekarimet qe ka bere ne formularin permbledhes te vete deklarimit (vërtetimin dhe listëpagesat, neni 82, pika 5/b LPP)*

**2.3.6.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

a. *Operatori Ekonomik duhet te disponoje 1 (një) mjete te blinduara ne pronesi me norme blindimi sipas Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr. 130, date 05.03.2018, jo me te ulet se BR 3. Pronesia e automjeteve te vertetohet duke paraqitur:*

1. *Autorizim, leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise*
2. *Lejen e Qarkullimit te tyre*
3. *Siguracion e detyrueshem per mjetet motorike, te vlefshem*
4. *Akt kolaudimi te vlefshem.*

   *Taksat e paguara*

b. Operatori Ekonomik duhet të vertetoje se disponon ne pronesi jo me pak se **3** (tre) arme krahu/te gjata zjarri. Per te vertetuar kete duhet te paraqese:

1. Autorizim per blerje arme krahu/te gjata zjarri leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise.
2. Kontrate shitblerje arme me nje shoqeri te licensuar per shitblerje armesh shoqeruar me numrin serial per secilen arme.

e. Faturat tatimore shoqeruar me mandat pagesat e bankes. Qe konfirmon kryerjen e pageses.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartesisht se kategoria e shërbimit përfshin disponimin e kategorisë së Licensës / Licensave 1.3.B për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, kështu që edhe armët e kërkuara në këtë objekt prokurimi do të përdoren për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike me Roje Private të subjekteve të Licensuara me Kategorinë 1.3.B.”

**Argumentimi:***Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të*

*dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

*Automjetet janë kërkuar për raste të ndërhyrjes emergjente, verifikimin e sinjaleve të alarmit si dhe patrullim nga Grupi i Gatshëm pranë objekteve që do të ruhen nga OE. Numri i automjeteve eshte kerkuar ne baze te numrit te objekteve qe do te ruhensi dhe distances qe kane keto objekte nga njera tjetra, gjithsej jane 3 (tre) objekte/vendroje, dhe shperndarjes se objekteve/vendrojeve në sipas qyteteve përkatëse. Dhe 3 (tre) automjetet e kërkuara nga AK janë të mjaftueshme për kryerjen e objektit të prokurimit. Po ashtu numri i automjeteve eshte kerkuar ne baze te numrit te vendndodhjes se objekteve/Arkave dhe distances midis tyre dhe Degeve te Bankave te Nivelit te Dytë. Gjithsej jane 2 (dy) mjete te blinduara, 1 (nje) qe do te kryeje sherbimin ndersa i dyti ne gadishmeri ne rast se difektohet mjeti qe kryen sherbimin.*

*Kriteri për pronësinë e armëve (të gjata dhe të shkurtra) bazohet në nenin 7 e vijues të Ligjit nr. 74/2014 "Për armët" si dhe nenet 32, 33, 34, 35 të Ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Numri i armëve 7 (shtatë) është përcaktuar numrit të vendrojeve 7 (shtatë).*

---

*Kriteri për pronësinë e armëve (të gjata zjarri) bazohet në nenin 7 e vijues të Ligjit nr. 74/2014 "Për armët" si dhe nenet 32, 33, 34, 35 të Ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Numri i armëve 3 (tre) është përcaktuar numrit të vendrojeve 3 (tre).*

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike dhe termat e references jane hartuar nga specialistet e fushes.*

*Kriteret e vecanta te kualifikimit jane hartuar nga specialistet e fushes.*